

STATUTI I SHOQERISE
DRINA KONSTRUKSION SH.P.K

Bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare » i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMB-ETARE TE BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vullnetin e tyre te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Statutit vendosen te formojne shoqerine:

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELLA
NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 01.06.2023, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin
DRINA KONSTRUKSION SH.P.K

2. Themeluesi i shoqerise eshte:

- **Z. Hektor Bude**, atesia Nazif, shtetas shqiptar, lindur me 31.12.1976 ne Polican dhe banues ne Polican, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit me nr personal me Nr. H612310021.

NENI 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shogerie do te jete:

Sherbime ne fushen e ndertimit, montimit, projektimit dhe zbatimit. Ndertimi i objekteve publike e private, rikonstruksioni e riparimi i tyre dhe ne pergjithesi te gjitha aktivitetet e sherbimet qe lidhen me fushen e ndertimit. Germime dheu, murature e beton arme. Prishje dhe punime ne toke te germuar. Ndertim mbi shtresa rrugore, punime hekurudhore, punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit. Ndertim ujesjelles-kanalizime, kanale e impiante vaditese, punime mbrojtese te sistemit hidraulik-çimentime.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimarise se shoqerise eshte pa afat.

NENI 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Polican, Berat, Fshati Peshtan, rruga Bodes, Zona Kadastrale 1678, Godine nje kateshe me nr. Pasurie 388.

KREU II
KAPITALI

NENI 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali baze fillestar i shoqerisë DRINA KONSTRUKSION SH.P.K. eshte 10,000.00 (dhjetë mije) leke dhe tërësisht i paguar nga ortaku i vetem i shoqerise sipas pjesëmarrjes ne kapitalin e shoqërisë.

Kontributi i ortakut përbën kapitalin themeltar dhe te regjistruar te shoqerise: "DRINA

KONSTRUKSION” SH.P.K. Kapitali shoqerise “DRINA KONSTRUKSION” SH.P.K perbehet nga kuota si me poshte vijon:

- a) **Kuota I** e cila perfaqeson 100 (njqind) % te kapitalit me te gjitha te drejttat dhe detyrimet ne pronesi /emer te **Z.Hektor BUDE** identifikuar si me siper.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompeterte e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shocierie me pergjegjesi te kufizuar e te drejttat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a)Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b)Ndryshimet e statutit
- c)Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d)Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e)Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f)Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire
- g)pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- i)Miratimi i bilanceve
- j)Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- k)Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre

- l) Miraton rregulla procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E Mbledhjes SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiper nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me 3/4 e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKB** per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te dreften e notes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shogeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administratori i pare i shoqerise:

1. Hektor Bude, atesia Nazif, shtetas shqiptar, lindur me 31.12.1976 ne Polican dhe banues ne Polican, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit me nr personal me Nr. H612310021.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR —EKSPERTET

NENI 16

Viti financiar fillon me 1 (nje) Janar dhe perfundom me 31 (tridhjetenje) Dhjetor. Rast i vecante viti i pare fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 (tridhjetenje) Dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Ekspteri ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te fine i ngarkuar riga aria e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre ekspertit kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit fmanciar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentit
- d) Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit
- e) Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shocierite tregtare.

NENI 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jete te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren.

Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me ³/₄ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22

MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe me vlere te njejte ligjore.

Ky akt pasi ju lexua prej meje, Kontabilistit dhe pasi u sigurova qe e kuptojne teresisht dhe e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, lejoj nenshkrimin dhe e legalizoj ate sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
Hektor BUDE

KONTABEL I MIRATUAR
Sheme RUCI

